

TEKNO FIRE SH.P.K.

PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

Përmbajtja

Pasqyra e Pozicionit Financiar	1
Pasqyra e Performancës & e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto	4
Shënimet Shpjeguese	5

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 u aprovuan nga administrator i shoqërisë dhe u nënshkruan si më poshtë:

	Shënime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
AKTIVET			
I. Aktivet Afatshkurtra			
Mjete monetare	4	18,160,101	6,266,378
Të drejta të arkëtueshme	5	892,413,954	797,019,648
Të tjera të drejta të arkëtueshme	6	-	20,562,021
Inventarët	7	77,965,068	88,743,438
Të tjera të drejta afatshkurtra	8	374,199,560	189,414,062
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,362,738,683	1,102,005,547
II. Aktivet afatgjata			
Aktive financiare	9	72,320,870	46,437,120
Aktive materiale	10	516,674,007	397,004,810
Aktive jo-materiale	11	1,418,269	5,194,126
Totali i aktiveve afatgjata		590,413,146	448,636,056
TOTALI I AKTIVEVE		1,953,151,829	1,550,641,603
DETYRIMET			
I. Detyrimet afatshkurtra			
Detyrime tregtare	13	440,630,777	362,755,745
Të pagueshme ndaj punonjësve	14	44,659,219	55,228,246
Të pagueshme për detyrime tatimore	15	355,138,759	225,847,743
Të tjera detyrime	16	184,553,023	177,770,522
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,024,981,778	821,602,256
II. Detyrime afatgjata			
Detyrime financiare	17	215,709,236	117,484,651
Totali i detyrimeve afatgjata		215,709,236	117,484,651
Totali i Detyrimeve		1,240,691,014	939,086,907
III. Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nënshkruar	18	179,000,000	179,000,000
Diferenca perkthimi		(15,619,974)	(726,602)
Fitimi i pashpërndarë		433,281,298	298,593,188
Fitim (humbja) e vitit		115,799,491	134,688,110
Totali i Kapitalit		712,460,815	611,554,696
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		1,953,151,829	1,550,641,603

Gërmaz Çejku

Përfaqësues ligjor

Kjo pasqyrë duhet të lexohet bashku me detyrimet shpjeguese në faqet 4 – 14, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyra e Performancës & e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	18	1,734,813,900	1,623,041,437
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit		80,171,744	179,195,560
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	19	(265,089,267)	(222,120,505)
1. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme			
Shpenzime të personelit	20		
1. Paga dhe shpërblime		(574,349,356)	(516,144,898)
2. Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(246,843,584)	(195,380,822)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9/10	(71,042,375)	(38,081,660)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	21	(505,097,566)	(631,062,409)
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		152,563,496	199,446,703
Shpenzime financiare			
1. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme			
2. Shpenzime të tjera financiare	22	5,687,500	(28,861,609)
Fitimi (humbja) para tatimit		158,250,996	176,646,819
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23		
1. Shpenzimi i tatimit fitimit të periudhës		(42,451,505)	(35,896,984)
Fitimi (humbja) neto e vitit		115,799,491	134,688,110
Totali i te ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse per vitin			
Totali i te Ardhurave Gjithëpërfshirëse per vitin		115,799,491	134,688,110

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 4 – 14, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

(metoda indirekte)	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
I. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit		
Fitim/ Humbja e periudhes	115,799,491	134,688,110
Rregullime per shpenzimet jomonetare:		
Shpenzime konsumi & amortizimi	71,042,375	38,081,660
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Ndryshime ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit:		
Renie / (rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	(259,617,783)	(649,301,279)
Renie / (rritje) ne inventare	10,778,370	(64,145,282)
Rritje / (renie) ne detyrimet e pagueshme	77,875,032	273,490,543
Rritje / (renie) ne detyrimet per punonjesit	(10,569,027)	44,782,047
Rritje / (renie) ne detyrimet e tjera	137,262,566	311,732,250
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	142,571,024	89,328,049
II. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit		
c. Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(242,519,860)	(106,618,338)
d. Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	54,395,096	
e. Pagesa per blerjen e investimeve te tjera	(25,883,750)	(24,978,070)
f. Arketime nga shitja e investimeve te tjera		
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e investimit	(214,008,514)	(131,596,408)
III. Fluksi I Mjeteve Monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit		
a. Arketime nga emetimi i kapitalit		
b. Arketime nga emetimi i aksioneve te perdorura si kolateral		
c. Hua te arketuara	98,224,585	55,618,236
j. Dividende te paguar		(28,201,093)
Mjete monetare nga / perdorur ne aktivitetin e financimit	98,224,585	27,417,143
IV. Rritja/(pakesimi) neto i mjeteve monetare	26,787,095	(14,851,216)
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	6,266,378	21,844,196
Diferenca perkthimi	(14,893,372)	(726,602)
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	18,160,101	6,266,378

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 4 – 14, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Diferenca për kërkim	Rezerva ligjore	Rezerva e kapitalit	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbje e vitit	Totali
Pozicioni financiar i deklaruar më 1 janar 2023	179,000,000						326,794,281		505,794,281
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									
Fitimi / Humbja e vitit								134,688,110	134,688,110
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									
Diferenca për kërkim			(726,602)				(28,201,093)		
Dividendë të paguar									
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									
Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2023	179,000,000		(726,602)				298,593,188	134,688,110	611,554,696
Efekti i ndryshimeve në kurset e këmbimit për kërkimin në konsolidim									
Pozicioni financiar i deklaruar më 1 janar 2024	179,000,000						433,281,298		612,281,298
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:									
Fitimi / Humbja e vitit								115,799,491	115,799,491
Transaksionet me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:									
Diferenca për kërkim			(14,893,372)						
Dividendë të paguar									
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike									
Pozicioni financiar i deklaruar më 31 dhjetor 2024	179,000,000		(15,619,974)				433,281,298	115,799,491	712,460,815

Kjo pasqyrë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 4– 14, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Shënimet Shpjeguese

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria Tekno Fire Sh.p.k. (në vijim referuar si "Shoqëria") është e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 07/01/2010 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria është e regjistruar në Degën e Tatimeve dhe Taksave Tiranë me NIPT/NUIS L01307010S.

Shoqëria ka një degë në Itali, Tekno Fire Sh.p.k. – Italy Branch me objekt aktiviteti instalimi i punimeve elektrike, hidraulike dhe të tjera ndërtimore dhe instaluese më 4 shtator 2019.

Shoqëria zhvillon aktivitet në fushën ndërtimit në objekte të ndryshme, në fushën e punime hidraulike, tregtimin me shumicë dhe pakicë, import eksport, në fushën e ndërtimit në objekte të ndryshme. Kapitali fillestar i shoqërisë është 179.000.000 Lekë, i cili zotërohet 100% nga ortaku i vetëm Alban Çejku.

Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Z. Gramoz Çejku.

Adresa e shoqërisë është: Autostrada Tirane-Elbasan, KM 2 ndodhur në Z.kad 366, Ndertese me 2 kate, Kati I-re, Numri i punonjësve të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 212 punonjës [2023: 246].

2. BAZAT E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) në Shqipëri. Shoqëria nuk pret të ketë shmangie kundrejt shumave të buxhetuara për vitin 2025.

Drejtimi i shoqërisë vlerëson se shoqëria do të vijojë aktivitetin normal tregtar për 12 muajt që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare. Për rrjedhojë, pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2024 janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë. Bazuar në SKK 11 "Tatimi mbi të Ardhurat", paragrafi 4, Shoqëria ka vendosur të mos njohë tatimet e shtyra në pasqyrat e saj financiare.

2.2 BAZAT E MATJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PARAQITJES

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë, monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 VLERËSIME DHE GJYKIME

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga shoqëria.

2.5 KRAHASUESHMËRIA

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit.

3 POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 TRANSAKSIONET NË MONEDHË TË HUAJ

Transaksionet në monedhe të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhe të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit, të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është percaktuar vlera e drejtë.

Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit me 31 Dhjetor 2024 lekë/ euro është 98.15 [2023: 103.88].

Kursi i këmbimit të Lekut për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

	Kursi mesatar 2024	Kursi i raportimit 2024	Kursi mesatar 2023	Kursi i raportimit 2023
ALL / EUR	100.70	98.15	108.75	103.88

3.2 INSTRUMENTA FINANCIAR

Instrumentat financiarë jo-derivative përbëhen nga llogari të arketueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, si dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivative njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç sa përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. në vijim të njohjes fillestare.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parase së aktivitetit financiar ose kur

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyres së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël dhe paraqitje të aplikuara nga Shoqëria që të kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet si ato financiare dhe ato jo financiare. Atje ku është e aplikueshme, informacion shtesë në lidhje me supozimet e bëra për përcaktimin e vlerës së drejtë është përfshirë në shënimet shpjeguese të aktivitetit apo detyrimit përkatës. Vlera e drejtë e vlerësuar e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, e kërkesave për t'u arkëtuar dhe e detyrimeve për t'u paguar është e ngjashme me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

(i) *Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kane jetë gjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e sherbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit duke filluar nga dita e pare e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirase dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Kategoria e aktivitetit	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Instalime teknike, makineri, pajisje	Lineare	20%
Pajisje zyre	Lineare	20%
Pajisje Informatike	Lineare	25%

3.4 ZHVLERËSIMI

(i) Aktivitet financiar

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parase të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

(ii) Aktivet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të Shoqërise, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve

3.5 PROVIZIONET

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parase me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 NJOHJA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat njihen në pasqyrën e performancës në përputhje me SKK 8 Të ardhurat. Në rastet kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e shërbimeve mund të matet me besueshmëri, të ardhurat e lidhura me këtë transaksion njihen në varësi të fazës së përfundimit të shërbimit në fund të periudhës së raportimit. Rezultati i një transaksioni mund të matet me besueshmëri kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Arkëtimi i pagesës nga kryerja e shërbimit është i mundur;
- Volumi i kryerjes së shërbimit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri;
- Shpenzimet e bëra për shërbimin, si dhe ato që do të bëhen për përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat gjenerohen nga shërbimet e ofruara klientëve dhe asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove përkatëse.

3.7 TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

3.8 SHPENZIME PËR PERSONELIN

Gjatë aktivitetit të saj normal, Shoqëria kryen pagesa në emër të saj dhe të punonjësve të saj për kontributet e sigurimit shoqërore dhe shëndetësore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kostot përkatëse të bëra në emër të Shoqërisë njihen në pasqyrën e performancës në momentin kur ndodhin.

3.9 TATIMI MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për tu paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin, duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15% e fitimit të tatueshëm.

4. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTËT E TYRE

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Mjete monetare EUR	12,255,126	5,803,227
Mjete monetare ALL	5,904,975	463,151
Totali	18,160,101	6,266,378

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogari të arkëtueshme më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Kërkesa të arkëtueshme	892,413,954	797,019,648
Totali	892,413,954	797,019,648

6. TË TJERA TË DREJTA AFATSHKURTRA

Të tjera të drejta afatshkurtra më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
TVSH e arkëtueshme	-	20,562,021
Total	-	20,562,021

7. INVENTARE

Inventare më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Mallra e materiale	77,965,068	88,743,438
Total	77,965,068	88,743,438

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

8. TË TJERA TË DREJTA AFATSHKURTRA

Të tjera të drejta afatshkurtra më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Huadhenie te treteve	115,304,548	137,223,890
Huadhenie me pale te lidhura	62,386,203	-
Parapagime te dhena	161,143,496	51,622,987
Marredhenie me Tekno Fire-dega Hungari	1,472,250	-
Shpenzime të periudhave të ardhme	389,656	567,185
Te ardhura te llogaritura	33,503,407	-
Totali	374,199,560	189,414,062

9. AKTIVE FINANCIARE

Aktivët afatgjatë financiarë të shoqërisë më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Aktive financiare	72,320,870	46,437,120
Totali	72,320,870	46,437,120

10. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivët afatgjatë materiale të shoqërisë më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Toka	13,486,500	6,586,500
Ndërtesa	231,169,668	204,095,509
Instalime teknike	12,702,787	14,193,262
Mjete transporti	244,424,244	150,592,189
Mobilje dhe pajisje zyre	1,594,319	1,641,483
Pajisje informative	13,296,489	19,895,867
AA materiale ne proçes	-	-
Totali	516,674,007	397,004,810

Amortizimi

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Aktivët afatgjatë materiale	71,042,375	38,081,660
Aktivët afatgjatë jomateriale	-	-
Total	71,042,375	38,081,660

11. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE

Aktivët afatgjatë jomateriale të shoqërisë më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Patenta, licenca, të drejta të tjera të ngjashme	1,418,269	5,194,126
Totali	1,418,269	5,194,126

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

12. DETYRIME FINANCIARE

Detyrime financiare më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	381,207,248	313,597,605
Parapagime të marra	59,423,529	49,158,140
Total	440,630,777	362,755,745

13. DETYRIME NDAJ PUNONJESVE

Detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Të pagueshme ndaj punonjësve	44,659,219	55,228,246
Total	44,659,219	55,228,246

14. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Detyrim për Sigurimet Shoqërore & Shëndetsore	131,151,521	119,243,035
Detyrim për Tatimin mbi te Ardhurat	91,535,243	67,757,198
TVSH e pagueshme	66,661,749	-
Tatim fitimi	65,790,246	38,847,510
Total	355,138,759	225,847,743

15. TE TJERA DETYRIME

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Hua nga pale të lidhura	178,949,672	14,292,466
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve	-	163,478,056
Te ardhura të shtyra	5,603,351	-
Totali	184,553,023	177,770,522

16. DETYRIME FINANCIARE AFATGJATA

Detyrime financiare afatgjata më 31 dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Hua bankare afatgjate	215,709,236	117,484,651
Total	215,709,236	117,484,651

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

17. KAPITALI I VET

Kapitali i vet më 31 dhjetor 2024 paraqitet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
Kapitali i nënshkruar	179,000,000	179,000,000
Diferenca perkthimi	(15,619,974)	(726,602)
Fitimi / Humbja e mbartur	433,281,298	298,593,188
Fitim (humbja) e vitit	115,799,491	134,688,110
Fitim (humbja) e vitit	712,460,815	611,554,696

18. TË ARDHURA NGA SHËRBIMET E KRYERA

Të ardhurat nga shërbimet më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	1,734,813,900	1,623,041,437
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	80,171,744	179,195,560
Total	1,814,985,644	1,802,236,997

19. MATERIALE TË KONSUMUARA

Materialet e konsumuara më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Mallrat, lëndët e para dhe shërbimet	265,089,267	222,120,505
Total	265,089,267	222,120,505

20. SHPENZIME PERSONELI

Shpenzimet e personelit më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Pagat	574,349,356	516,144,898
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	246,843,584	195,380,822
Total	821,192,940	711,525,720

21. SHPENZIME TË TJERA

Shpenzimet e tjera më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Shpenzime konsulence	91,214,801	88,552,166
Shpenzime sigurimi	785,267	-
Sherbime per punime & instalime	102,130,684	90,995,847
Shpenzime komunikimi	593,389	557,724

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Shpenzime kancelari	169,195	359,734
Shpenzime udhetime dhe dieta	64,165,303	69,127,391
Qira	61,125,307	79,448,520
Mirëmbajtje dhe riparime	21,749,042	13,783,166
Taksa lokale dhe të tjera të ngjashme	8,174,141	6,879,537
Shpenzime marketingu	570,097	2,013,070
Subvencione të dhena	2,358,000	-
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	70,675,283	60,073,912
Gjoha dhe penalitete	4,041,675	1,807,663
Shpenzime të tjera	77,345,382	217,463,679
Total	505,097,566	631,062,409

22. TË ARDHURA / SHPENZIME FINANCIARE – NETO

Të ardhurat / shpenzimet neto financiare më 31 dhjetor 2024 paraqiten si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Te ardhura financiare:		
<i>Të ardhura nga interesat</i>	6,364,662	10,111
<i>Të ardhura të përealizuara nga kembimet</i>	-	-
<i>Të ardhura të realizuara nga kembimet</i>	21,370,833	6,163,389
	27,735,495	6,173,500
Shpenzime financiare:		
<i>Shpenzime për interesa</i>	(13,985,425)	(9,575,568)
<i>Komisione bankare</i>	(1,958,056)	(1,780,923)
<i>Humbje të përealizuara nga kembimet</i>	-	-
<i>Humbje të realizuara nga kembimet</i>	(6,104,514)	(23,678,618)
	(22,047,995)	(35,035,109)
Total	5,687,500	(28,861,609)

23. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Rezultati kontabël i shoqërisë është fitim në vlerën 158'250'996 lekë, ndërkohë shpenzimet e panjohura janë 21'787'089 lekë dhe rezultati fiskal është fitim në vlerën 180'038'085 lekë. Tatimi mbi fitim rezulton në vlerën 27'005'713 lekë.

Bazuar në legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për biznesin e madh për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2024 [2023: 15%] ndërsa norma e tatimit fitimit për Degën në Itali për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 është 24%. Shoqëria ka kryer kreditimin e tatimit fitimit të paguar në Itali ku ky reduktim kalon nivelin e tatimit që aplikohet në Shqipëri, në bazë të legjislacionit fiskal shqiptar.

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

PËR PERIUDHËN E MBYLLUR MË 31.12.2024

(SHUMAT NË LEKË, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Shpenzimi i tatim-fitimit përfshin si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023
Fitimi Kontabel	158,250,996	170,585,094
Shpenzime te panjohura sipas ligjit fiskal		
Shpenzime te tjera	16,345,625	8,476,358
Gjoha dhe penalitete	5,213,464	1,321,344
Shpenzime te pritjes e perfaqesimit	228,000	2,056,218
Totali i shpenzimeve te panjohura	21,787,089	11,853,920
Fitimi i tatueshem	180,038,085	182,439,920
Humbje e mbartur		
Tatimi mbi fitimin @ 15%	27,005,713	27,365,852
Tatimi mbi fitimin @ 15% per Italine	7,946,718	5,757,965
Tatim fitimi kreditor	19,058,995	21,607,887

24. ANGAZHIME DHE PASIGURI

Gjatë aktivitetit normal të biznesit, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime të ndryshme nga të tretë dhe masa ligjore. Vecanërisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri në fuqi ose që konsiderohet si i hyrë në fuqi në fund të periudhës raportuese, është objekt i interpretimeve të ndryshme përse i përket zbatimit të tij për transaksionet dhe aktivitetet e Shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndërmarrë nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbështet qëndrimet tatimore mund të kundërshtohet me sukses nga autoritetet përkatëse. Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Në rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha më të gjata.

Me 31 dhjetor 2024, Shoqëria nuk ka angazhime kapitale apo operacionale të kontraktuara por ende të papaguara.

25. NGJARJE TË MËPASSHME

Nuk ka asnjë ngjarje të mëpasshme pas datës së raportimit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.